



Planuar / Preraport Planned / Pre-Report Expected / In-Report	25-06	1	vit year
Organ / Organi Organization / Org. Unit	3315/2021	1/3	Sasia Kohëzgjatësi Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.416/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari -anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.416/2021 të datës 14.05.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga “Sef Kosharja”, Lagjja Malësia, Komuna e Kamenicës, kundër organit të punësimit komunës së Kamenicës në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 25.06.2021 mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.416/2021 e datës 14.05.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi** Vërejtja me shkrim për shkelje disiplinore e datës 16.04.2021 me numër:10728 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Sektorit për Gjendje Civile.

A r s y e t i m

Ankuesit, sipas Akt Emërimit me nr.452/194 të datës 15.09.2011 i punësuar në Komunën e Kamenicës në pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile”, Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile me datë 16.04.2021 i ka shqiptuar masën disiplinore Vërejtje me shkrim për shkelje disiplinore.

Ankuesi, kundër masës disiplinore “Vërejtje me shkrim për shkelje disiplinore” të shqiptuar me datë 16.04.2021 nga Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile, ka parashtruar ankesë me datë 14.05.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është regjistruar me numër protokollit: 2384/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.05.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Kamenicës. Këshilli, me datë 04.06.2021 me numër protokollit 2876/2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 14.05.2021 me numër protokollit 2384/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 24.03.2021 dërguar nga ankuesi për Hyrije

Dërvodelli; E-mailin e datës 24.03.2021 dërguar nga Hyrije Dërvodelli për ankuesin; E-mailin e datës 24.03.2021 dërguar nga Inspektorati i Agjencisë së Regjistrimit Civil dërguar për Hyrije Dërvodelli; Kopjen e regjistrimit të lindurve me numër rendor:397/14 i datës 17.12.2014; Vërejtjen me shkrim për shkelje disiplinore e datës 16.04.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.05.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 04.06.2021 me numër protokoll 2876/2021; Akt emërimit e ankuesit të datës 15.09.2021 me numër:452/194; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e ankuesit; Vërejtjen me shkrim të datës 19.01.2021 me numër:1336; Procesverbalin e paralajmërimit (qortimit) me gojë për ankuesin i datës 07.08.2020 me numër:16496; Shkresën e datës 08.06.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se shqiptimi i masës disiplinore “Vërejtjes me shkrim për shkelje disiplinore” i datës 16.04.2021 nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë nuk është i bazuar ngase lëshimi ka të bëjë vetëm me gabim teknik gjatë përshkrimit në libër ngase regjistrimin në sistemin e gjendjes civile e ka bërë ish shefi i Gjendjes Civil tani më i ndjerë R.V si dhe inspektorati i ARC-së nuk ka kërkuar të ndërmerren masa ndaj meje por vetëm me lëndën në fjalë.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile me datë 16.04.2021 i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore “Vërejtje me shkrim për shkelje disiplinore”.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik është i obliguar t’i përmbushë detyrimet për respektimin e ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit dhe të drejtave të njeriut siç parashihet me nenin 25 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3.Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”, po ashtu “Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij” siç parashihet edhe me nenin 28 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 45 paragrafi 1.1; 1.2;1.3;1.4 dhe 1.5 i të njëjtit ligji i cili përcakton se: “Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit vërejtjen me shkrim të datës 16.04.2021 e ka shqiptuar pas pranimit të e-mailit të datës 24.03.2021 të pranuar nga inspektorati i ARC-së të cilët me rastin e vizitës në Komunën e Kamenicës kishin gjetur se sipas ekstraktit të evidentuar me numër serik EO1967705 ishte ndërhyrë tek data dhe vendi i lindjes në Librin Themeltar të Gjendjes Civil me ç ‘rast ishte konstatuar se regjistrimi i kësaj lindje ishte i pabazë duke rekomanduar që të ndërmerren masat e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi, andaj me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit, udhëheqësja e drejtpërdrejtë ka vepruar në pajtim me dispozita e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 46 paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.2 i cili përcakton se: “Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.2. shkelje të lehta” si dhe nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 si dhe neni 48 paragrafi 1 i të njëjtit ligj përcakton se: “1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”, po ashtu edhe me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik neni 7 paragrafi 1 dhe 4 i cili përcakton se: “1. Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë në rastet kur vihet në



dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, nëpërmjet ankesave nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit, e vlerëson paraprakisht atë; 4. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit”, pasi që kishte vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe bazën juridike, ngase ankuesi sipas përshkrimit të detyrave të punës ishte i ngarkuar me dokumentacionin-ekstraktit të evidentuar me numër serik EO1967705 i cili kishte rezultuar të ishte ndërhyrë apo ndryshuar në datën dhe vendin e lindjes siç ishte paralajmëruar nga inspektorati i Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga Komuna e Kamenicës të datës 04.06.2021, ka konstatuar se ndaj ankuesit udhëheqësja e drejtpërdrejt me datën 07.08.2020 i ka – paralajmërimin (qortim) me gojë përmes së cilës në bazë të procesverbalit me numër: 16496 ankuesit i është tërhequr vërejtje se, citoj: “1. Mos ofrimi i dëshmisë/dëftesës së pagës për qytetarët për shërbimet që marrin paraqet shkelje disiplinore, 2. Qytetarët që pajisen me certifikata të ndryshme në momentin e pranimit të certifikatës të pajisen me dëftesën e pagesës nga ana juaj si dhe 3. Dështimi i përmirësimit do të pasojë me masa tjera disiplinore”, ndërsa me datë 19.01.2021 ankuesit i është shqiptuar edhe masa tjetër disiplinore vërejtje me shkrim për shkak se i njëjti citoj: “... duke mos u barazuar me certifikatat e marra dhe të lëshuara nga sistemi për vitin kalendarik” i cili rezulton më një diferencë prej (-195) ekzemplarëve të certifikatave, me specifikimin se nëse i njëjti nuk i respekton rekomandimet do të iniciohet procedurë disiplinore për shkelje të rënda disiplinore, andaj ngase u tha më lartë ankuesit në vazhdimësi brenda një periudhe prej datës 07.08.2020 deri me datë 19.01.2021 para se t’i shqyrtohet vërejtja e fundit e cila është objekt shqyrtimi në këtë ankesë, paraprakisht i janë shqiptuar edhe dy masa tjera disiplinore, rrethanë kjo e cila dëshmon se ankuesit në vazhdimësi i është tërhequr vërejtja për respektim të dispozitave ligjore si dhe përmbushje të detyrave dhe obligimeve ligjore që rrjedhin me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës siç përcaktohet me dispozitat Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 27 paragrafi 1 ku përcaktohet se: “Zyrtari publik është i obliguar të menaxhojë me kujdes pasurinë shtetërore, që i vihet në detyrim për ushtrimin e detyrës dhe të përdorë atë vetëm për qëllimin e përcaktuar me ligj dhe sipas rregullave të brendshme të institucionit”.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me A.nr.416/2021

Flakron GASHI


Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Personelit në Komunën e Kamenicës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

